



Proc.e auditimit mostrimi I I

1. Procedurat e pavarura dhe analitike
2. Çmuarjet kontabël
3. Mostrimi në auditim
4. TANK
5. Përdorimi i punës së të tjerëve

Procedurat e pavarura

Janë teste për të përfituar evidenca të auditimit për të zbuluar gabime materiale në p.f. Janë dy lloje:

- Procedurat analitike
- Procedura të tjera - Testet e detajuara, Minutat, marrja në pyetje



Testet e detajuara

Testet e pavarura krijohen për të zbuluar gabimet ose mangësit.

- Procedurat e pavarura ndahen në dy nënkategori:
 - 1) Teste për të zbuluar gabimet
 - 2) Teste për të zbuluar mangësitë

Testet për të zbuluar gabimet fillojnë me regjistrat e kontabilitetit dhe vazhdojnë deri në dokumentin mbështetës. Psh.nëse shitjet janë bërë me çmimin e duhur.

Testet për të zbuluar mangësitë fillojnë me regj.e kont.të marrë nga jashtë dhe vazhdohet me kontrollin e tyre në regj.e kontabilitetit.psh.nëse të gjitha blerjet e lëndës parë janë përpunuar siç duhet?


Testet e drejtuara

- Janë teste të krijuara enkas për të zbuluar edhe gabimet edhe mangësitë.
- Lloji dhe drejtimi i këtyre testeve duhet të dihen para se të zgjidhet mostra e testit.
- Janë të duhura në rastet kur testohen pohimet e p.f. si:
 - Ekzistenca
 - Plotësia
 - Të drejtat dhe obligimet
 - Vlerësimi
- Koncepti i testeve të drejtuara është nxjerrë nga karakteri i dyfishtë i transaksioneve (për çdo **Dr** duhet të ketë një **Cr**), prandaj, gabimet e regjistruara në **Dr** duhet të rezultojnë ose në **Cr**, ose në regjistrim në drejtim të kundërt në një regjistrim në **Dr**.



Testet e drejtuara

- Avantazhi kryesorë i çasjes së drejtuar të auditimit është efektiviteti i kostos.
 - a) pasurit dhe shpenzimet testohen vetëm për mbivlerësime, detyrimet dhe të hyrat për nënvlerësime
 - b) këto teste auditojnë llojet e gabimeve të transaksioneve si, të hyrat e paregjistruara dhe shpenzimet e gabuara (të bëra me ose pa qëllim)



Procedurat analitike

- Përdoren në të gjitha fazat e auditimit. Kur përdoren si teste të pavarura, duhet patur parasysh vlefshmërin, përkatësinë dhe krahasueshmërin e tyre.

Procedurat analitike përfshijnë:

- a) Mbjtjan parasysh të krahasimeve me:
 - Informacionet e ngjashme me periudhat e më parshme
 - Rezultatet e pritura të entitetit sipas buxheteve ose parashikimeve
 - Parashikimet e përgatitura nga auditorët
 - Informacionet rreth industrisë
- b) Ato elemente të infor.fin.të cilat pritet të sillen sipas një mënyre të caktuar (psh.marëdhënje midis FB dhe Shitjeve)
- c) Ato elemente të infor.fin.të cilat janë funksion i infor.jo-fin.(psh.marëdhënjet midis kostove të pagave me numrin e punonjësve)



Hetimi i luhatjeve të mëdha

- Auditorët duhet të hetojnë luhatjet e mëdha dhe marëdhëniet e pa-parashikueshme kur procedurat analitike identifikojnë ato, për të përfitua shpjegime dhe evidenca të duhura vërtetuese.
 - Hetimet duhet të fillojnë me marrjen në pyetje të menaxhmentit dhe me vërtetimin e përgjigjeve të tij:
 - a) Duke krahasuar njohurit e auditorit rreth biznesit të entitetit dhe me evidencat tjera të përfituara gjatë auditimit
 - b) Nëse procedurat analitike janë duke u përdorur si procedura të pavarura, ndërmjet ndërmarrjes së procedurave shtesë të auditimit, por vetëm në rastet kur ato janë procedura të përshtatshme për të konfirmuar shpjegimet e marra.
- Nëse prej menaxhmentit nuk mundë të mirren shpjegime ose ato janë të pamjaftueshme, auditorët përcaktojnë se cilat procedura shtesë duhet ndërmarrë.

Teknika praktike

- Analiza e koeficientëve është një teknikë e dobishme vetëm nëse përdoren së bashku me teknikat e tjera. Ato përfshijnë:
 - a) **Ekzaminimin e p.f. bashkë me gjithë informacionet e tjera.** Psh. llogarit e të hyrave dhe shpenzimeve janë të lidhura ngusht me llogarit e B.Gj. Dhe në këtë rast duhet bëhen krahasime për t'u siguruar se marrëdhënjet janë të arsyeshme
 - b) **Analiza e prirjeve.** Për të krahasuar periudhën aktuale me periudhën e kaluar mundë të përdoren teknika të sofistikuara statistikore.
 - c) **Testet e arsyeshmërisë.** Përfshinë llogaritjen e vlerave të pritshme të një zëri dhe krahasimin e vlerës së llogaritur me atë aktuale, psh. Zhvlerësimi me metodën drejtëvizore.
(Kosto + shtesat – largimet) x zhvlerësimi% = Shpenzimet në PA

Letrat e punës

Duhet të përmbajnë rezultatet e plota të procedurave analitike, duke përfshi:

- Programe të detajuara të punës
- Përmbledhje të shifrave kryesore dhe marëdhënjet midis periudhave
- Përmbledhje të krahasimeve të bëra me buxhetet dhe me vitet e kaluara
- Detajet e të gjitha luhajtjeve të mëdha ose marëdhënjeve të pa-parashikueshme të marra në konsideratë
- Detaje të rezultateve të hetimeve rreth luhajtjeve ose marëdhënjeve mbi të cilat janë arritur konkluzionet e auditimit
- Informacionet që janë mbajtur parasysht e që kanë ndihmuar në planifikimin e auditimeve të mëpasshme.

Vlerësimet në kontabilitet

Vlerësimi në kontabilitet është llogaritje e përafërt e vlerës së një zëri në mungesë të një mënyre të saktë të matjes.


Për të vlerësuar faktin nëse vlerësimet janë të arësyeshme, auditimi i vlerësimeve të kontabilitetit duhet të:

- Testojë proceset e përdurura prej menaxhmentit
- Përdorë një testim të pavarur
- Rishikojë ngjarjet pas datës së bilancit të gjendjes.

Vlerësimet në kontabilitet

Vlerësimet – çmuarjet në kontabilitet përfshinë:

- **Lejimet** për të reduktuar stoqet dhe të arkëtueshmet deri në vlerën e tyre neto të realizueshme të vlerësuar
- **Provizionet** për të shpërndarë kostot e pasurive jo-qarkulluese mbi jetën e tyre të dobishme të vlerësuar
- **Të hyrat akruale**
- **Provizionet për humbjet** prej çështjeve gjyqësore
- **Humbjet prej kontratave** të ndërtimit në progres
- **Provizionet** për të përmbushur pretendimet për garanci.



Mostrimi në auditim

Nënkupton aplikimin e një procedure në më pak se 100% të llogarive të gjithëmbarshme apo klasëve të Transaksioneve për formulimin e një përfundimi.


Mostrimi i mundëson auditorit përdorimin e dëshmive të mjaftueshme me shpenzime të vogla.

Nuk përfshihet mostrimi në teste nëse:

- Testohen 100% të elementeve të një popullate
- Testohen të gjitha elementet e një karakteristike të caktuar.


Metodat e përdorura në zgjedhjen e mostrave mund të jenë:

- ***statistikore dhe***
- ***jostatistikore***



Mostrimi statistikor

- Bazohet në ligjin e probabilitetit – gjasave të zgjedhjes së shënimeve për të vlerësuar rezultatet e mostrimit. Gjatë vlerësimit të mostrave, statistika i lejon auditorit që të bëjë matjen sasiore (rrjedhimisht edhe t'a kontrollojë) të rrezikut të gabimit të mostrimit si rrjedhim i kontrollit të vetëm njërës pjesë të shënimeve nga popullata, prandaj përdorimi i sajë inkurajohet të përdoret bashkë me evidenca të tjera të auditimit për pjesën e mbetur të popullatës.
- Mostrimi statistikor zakonisht përdoret gjatë kontrollimit të popullatës të përbërë nga numër i madh i artikujve të njëtrajtshëm.



Mostrimi jo-statistikor

- Bazohet në përvojën e auditorit në përzgjedhjen e mostrave të përshtatshme.
- Mostrimi jo-statistikor zakonisht përdoret kur polullata përbëhet prej numri të vogël artikujsh me vlerë të lartë.
- Mostrimi në auditim përdoret si gjatë zbatimit të testeve të kontrollit poashtu edhe të procedurave të pavarura.
- TK-përdoren për vlerësimin e efikasitetit të KB në parandalimin, zbulimin dhe korigjimin e G dhe M
- PP-përdoren për sigurimin e dëshmive për vlerësimin e përshtatshmëris së deklaramit të llogarive apo klasëve të transaksionit në p.f.

Përcaktimi i mostrave

- Auditorët të mbajnë parasysh **objektivat** e procedurave të auditimit dhe **karakteristikat e popullatës** prej të cilës nxirret mostra, si dhe **metodën e mostrimit** dhe zgjedhjen e mostrës.
- **Gabim** – dmth. Ose një shmangje nga kontrolli gjatë kryerjes së testeve të kontrollit, ose gjatë kryerjes së procedurave të pavarura.
- **Gabimet e pritshme** – janë gabimet të cilat auditori pret të jenë të pranishme në popullatë.
- **Gabimi i pranueshëm** – është numri maksimal i gabimeve brenda popullacionit të cilin auditori do të ishte i gatshëm ta pranojë dhe të përfundojë se rezultatet e mostrimit i kanë përmbushur objektivat e auditimit.
- **Njësitë e mostrimit** – janë elementet individuale të cilat përbëjnë popullacionin.

Përcaktimi i mostrave

SNA-të kërkojnë që auditori të zgjedhë mostra duke u dhënë mundësi për përzgjedhje të gjithë popullacionit, dhe që mostrat e zgjedhura të e përfaqësojnë tërë popullacionin.

Metodat – teknikat e zgjedhjes së mostrave janë:

- a) Zgjedhja e rastësishme (perd.i tabelave)
- b) Zgjedhja sistematike (intervali i par i rastit)
- c) Zgjedhja në mënyrë të çrregullt (alternative e z.me lart)
- d) Zgjedhja një pas një ose në bllok (50 q.një pas një)
- e) Zgjedhja sipas njësisë monetare (MNjM)

Shtresëzimi – është proces i ndarjes së popullacionit në nën popullata ku secili prej tyre përfaqëson një grup mostrash, psh: vjetërsia ose shuma monetare.

Madhësia e mostrës

- Gjatë përcaktimit të madhësisë së mostrës, auditori duhet të konsiderojë nëse rreziku i mostrimit është zvogëluar në nivel të pranueshëm
- **Rreziku i mostrimit** – është Rr kur përfundimi i bazuar në rezultatet e mostrimit mundë të dallojë nga përfundimi i arritur po të ishte bërë testimi i tërë popullatës.
- **Rreziku i jo-mostrimit** – është rreziku kur auditori nxjerrë përfundim të gabuar për shkak të arsyeve që kanë të bëjnë jo me madhësinë e mostrës, *psh. Shumica e dëshmive të auditimit sigurohen për të krijuar bindjen e jo për të nxjerrë përfundime.*
- Rreziku i mostrimit zvogëlohet duke e rritur madhësinë e mostrës.
- Rreziku i jo-mostrimit zvogëlohet me anë të planifikimit, mbikëqyrjes dhe rishikimit të mirë të angazhimit.

Testet e kontrollit

Rreziqet me të cilët auditorët përballen te testet e Kontrollit janë:

- Rreziku i nën-mbështetjes (nuk mundet-mundet)
- Rreziku i mbi-mbështetjes (mundet-nuk mundet)

Rreziqet me të cilët auditorët përballen te procedurat e pavarura janë:

- Rreziku i refuzimit të gabuar (permban-nuk permban)
- Rreziku i pranimit të gabuar (nuk permban- permban)

Vlerësimi i rezultatave

Për të vlerësuar rezultatet e marra prej mostrës, Auditori duhet të:

- Analizojë gabimet e mostrimit
- Parashikojë gabimet e zbuluara me mostrim
- T'a rivlerësojë rrezikun e mostrimit

Fazat kyçe në procesin e mostrimit janë:

1. Përcaktimi i objektivave dhe popullatës
2. Përcaktimi i madhësisë së mostrës
3. Zgjedhja e metodës së zgjedhjes së mostrës
4. Analiza e rezultateve dhe parashikimi i gabimeve



TANK

Quhet përdorimi i kompjuterëve për kryerjen e punëve të auditimit.

Dy TNK-et më të përdorura janë:

- Softuerët për auditim, dhe
- Testet e të dhënave

Objektivat e auditimit nuk ndryshojnë kur auditimi kryhet në mjedis të kompjuterizuar.

TANK përdoret për kryerjen e shumë procedurave të auditimit, si:

- Testet e detajuara të trans.dhe terpricave të llogarive
- Procedurat e rishikimit analitik
- Testet e kontrolleve mbi sistemet informative kompjuterike.

Softuerët për auditim

Përbëhen prej programeve kompjuterike të përdorur prej Auditorëve si pjesë e procedurave të tyre të auditimit, për përpunimin e të dhënave të rëndësishme për auditimin të cilat merren prej sistemit të kontabilitetit të entitetit.

Auditori duhet të vërtetojë vlefshmërinë e këtyre programave. Softuerët zakonisht përbëhen prej këtyre elementeve:

- a) Pakot e programeve
- b) Programet e ndërtuara sipas qëllimit
- c) Programet e utilitetit

Softuerët për auditim përdoren si:

- Softuer për pyetje, të cilat vlerësojnë skedat e të dhënave të klientit
- Programe krahasuese të cilat krahasojnë versionet e një programi
- Softueri interaktivë për marrjen në pyetje të sistemeve (on-lina)
- Softuerët e kodeve rezidente që shërbejnë për rishikimin e transaksioneve gjatë kohës që ata përpunohen

Testet e të dhënave

Përdoren për kryerjen e procedurave të auditimi përmes futjes së të dhënave në sistemin kompjuterik të entitetit, dhe krahasimi i rezultateve të përfituara me rezultatet e para përcaktuara. Hapat kryesorë që ndiqen nga auditorët gjatë zbatimit të TANK janë:

- Caktimi i objektivave të TANK-ut
- Përcaktimi i përmbajtjes dhe qasjes ndaj skedave të entitetit
- Përkufizimi i llojeve të transaksioneve që do të testohen
- Përkufizimi i procedurave që do të kryhen mbi të dhënat
- Përkufizimi i kërkesave për outpute
- Identifikimi i personelit të auditimit dhe të teknologjisë informative i cili do të marrë pjesë në krijimin dhe zbatimin e TANK-ut
- Rishikimi i vlerësimeve të kostove dhe përfitimeve
- Siguria se përdorimi i TANK-ut është kontrolluar dhe dokumentuar ciç duhet
- Organizimi i aktiviteteve administrative, përfshirë aftësitë e duhura dhe paisjet kompjuterike
- Zbatimi i TANK-ut; dhe vlerësimi i rezultateve.

Përdorimi i punës së tjerëve

Eksperti është një person a firmë që zotëron aftësi specifike në një fushë të veçantë të ndryshme nga kontabiliteti dhe auditimi.

- Përdorimi i punës së një eksperti
- Përcaktimi i nevojës për të përdorur një ekspertë (kompetenca, kualif.profes.i tij)
- Kompetenca dhe objektiviteti i ekspertit
- Objekti i punës së ekspertit
- Vlerësimi i punës së ekspertit
- Përdorimi i punës së auditimit të brendshëm

Përdorimi i punës së auditimit të brendshëm

- Objekti dhe objektivat e auditimit të brendshëm
- Njohja dhe vlerësimi fillestar i rolit dhe objektit të auditimit të brendshëm
- Përdorimi i punës së auditimit të brendshëm
- Koha e kryerjes së punës dhe koordinimi
- Vlerësimi i punës specifike të auditimit të brendshëm
- Përdorimi i punës së të tjerëve prej auditimit të brendshëm

Organizatat për shërbime

- I ofrojnë shërbime organizatave tjera.
- Konsideratat e auditorit të klientit
- Përfitimi i evidencave të auditimit
- Raportet e auditorit të organizatës që jep shërbime

Raportimi

Raporti i auditorit mbi pasqyrat financiare është përgjegjësi vetëm e auditorit.

